

**VENDIM**  
**Nr.349, datë 1.6.2004**

**PËR FILLIMIN E NEGOCIMIT PËR DHËNIEN ME KONCESION TË ZONËS SË PORTO-ROMANOS, DURRËS DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.30, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË SHOQËRIVE, QË DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN INSTALIME BREGDETARE, PËR TRANSPORTIMIN DHE DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fillimin e negociimit për dhënie me koncesion, si propozim i pakërkuar, sipas projektit të shoqërisë Romano Port sh.a., për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, i miratuar me vendimin nr.21, datë 19.10.2001 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Procedura për administrimin e infrastrukturës portuale detare të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3. Dhënia me koncesion, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit në funksion të depozitave bregdetare të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 e 2 të këtij vendimi, të jetë e formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim).

4. Organi Shtetëror i Autorizuar për negociimin (OSHA) të jenë Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit, të cilët të ngrenë grupin e negociimit për marrëveshjen koncesionare përkatëse.

5. Përpara realizimit të marrëveshjes koncesionare të bëhet rakordimi i projektit të propozuar, ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe Qendrës Kombëtare Shkencore të Hidrokarbureve e Institutit të Kërkimeve të Transportit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike apo infrastrukturë”.

6. Negocimi dhe hartimi i marrëveshjes përfundimtare ndërmjet OSHA-së dhe koncesionarit të realizohen brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi. Në marrëveshjen koncesionare të përfshihet edhe rregullimi i marrëdhënieve ekonomiko-financiare, ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe OSHA-së, për administrimin e infrastrukturës portuale detare të ngarkim-shkarkimit dhe transportimit të naftës, gazit e të nënprodukteve të tyre, deri në depozitat magazinuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Pas këtij afati, në rast mosplotësimi të kushteve të pikës 6, vendimi humbet fuqinë vepruese.

8. Pika 13 e 14 të vendimit nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e zgjedhjes dhe rregullimin e marrëdhënieve të shoqërive, që do të ndërtojnë dhe do të përdorin instalime bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**